

Më  
Dana

08.05.2017

NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI PER KRIME TE RENDA**-si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtarin Sahit Krasniqi kryetar i trupit gjykues, dhe sekretaren juridike Adelina Sallahu, në lenden penale kundër të pandehurit [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së , sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.I.nr.141/16 të datës 05.12.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me 12.01.2017 ne prani te Prokurorit të shtetit Rasim Maloku, të pandehurit [REDAKTUAR], shpallë dhe publikisht komunikon këtë:

#### A K T G J Y K I M

I pandehuri [REDAKTUAR], i lindur me dt. [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR], nga i ati [REDAKTUAR] dhe e ëma [REDAKTUAR] e vajzërisë [REDAKTUAR] me vendbanim në Prishtinë rr. " [REDAKTUAR] " nr. [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR], i martuar, babë i tre fëmijëve, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i gjendjes së mirë ekonomike, me numër personal [REDAKTUAR] me numër telefoni [REDAKTUAR].

#### Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse: me datën 21.10.2016, rreth orës 21:00 në pikën kufitare Han i Elezit ka poseduar armën në kundërshtim me ligjin mbi armët numër 05/L-022 neni 22, në atë mënyrë që me rastin e hyrjes në Republikën e Kosovës dhe pas kontrollit të rregullt të veturës të tipit Land Rover ngjyrë e zezë me targa [REDAKTUAR] të cilën e drejtonte i pandehuri, në sirtarin në mes të ulëses së shoferit dhe të pasagjerit është gjetur një revole e llojit Smith & Wesson e modelit M&P9 me numër serik DXM5502 me dy karikator, një ri i mbushur me 12 fishek të kalibrit 9 mm i futur në revole dhe tjetri me 10 fishek të të nijetit kalibër ishte afër revoles, të cilat pastaj i sekuestrohen përkohësisht nga policia.

-me të cilën kreu veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata ne baze te neneve 3, 7, 17, 21, 41, 46, 73, e 374 par.1 te KPRK-së, si dhe te nenit 365 te KPPK-së të pandehurin e

## G J Y K O N

Të pandehurit [REDAKTUAR] shqipton dënim gjobe në shumë prej 300 (treqind) euro të cilin dënimin është i obliguar që ta paguaj ne afat prej 15 ditesh, pasi aktgjykimi te merr formën e prere.

Ne rast se dënimi me gjobe nuk mund te ekzekutohet ne format tjera te parapara me nenin 46 par. 3 të KPRK-së, dënimi i caktuar me gjobe do ti shndërrohet ne dënim burgu, ashtu qe për çdo 20 euro të pandehurit do ti llogaritet një dite burgu.

Ne baze te nenit 374 par.3 te KPRK-se, konfiskohet në mënyrë të përhershme arma – revolva e llojit Smith & Wesson e modelit M&P9 me numër serik DXM5502 me dy karikator dhe 22 fishek të kalibrit 9 mm, si dhe leja për armë shenjëtarie me numër AB1212013281486.

Obligohet i akuzuari që kësaj Gjykate të paguaj paushallin në shume prej 30 (tridhjetë) euro, në afat prej 15 ditëve pasi qe aktgjykimi te merr formën e prerë.

## A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda ka ushtruar aktakuzën PP.I.nr.141/16 të datës 05.12.2016 ndaj të pandehurit [REDAKTUAR] për shkak te veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar me dt. 12.01.2017 në të cilën, prokurori i shtetit Rasim Maloku mbeti në tërësi pranë aktakuzës duke i propozuar gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtorë dhe ti shqiptohet një dënim i paraparë me ligj.

I pandehuri [REDAKTUAR] në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale, për të cilën e ngarkon aktakuza në të gjitha pikat e saj, duke shtuar se për kryerjen e kësaj vepre penale është penduar.

Gjykata konstaton se janë plotësuar kriteret nga nen. 248 par.1 të KPPK-së nga se:

- i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë,
- pranimi i fajit është bërë vullnetarisht nga të pandehuri,
- i cili pranim mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit siç janë vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm i sendeve i datës 30.10.2016, lista e armëve të konfiskuar përkohësisht e dt. 30.10.2016, si dhe foto dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, kryetari i trupit gjykues konform nenit 248 par. 4 të KPPK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit (*nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vleron se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mundë të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt. 19.03.2013*).

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit formësohen të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të pa autorizuar të armeve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, meqë me datën kohën dhe vendin siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi, i pandehuri në veturën tij Land Rover, ngjyrë të zezë me targa 01-449-AA, në sirtarin në mes të ulëses së shoferit dhe pasagjerit ka poseduar revolen e llojit Smith & Wesson, të



modelit M&P9 me numër serik DXM5502 me dy karikator, njëri i mbushur me 10 fishek dhe tjetri me 12 fishek të kalibrit 9 mm.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësin e dënimit në kuptim të nenit 73 të KPPK-së, si rrethana **lehtësuese** mori se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën e kryer penale, se për të njëjtën armë i pandehuri ka poseduar leje shenjëtarie me numër AB1212013281486 në të cilën në mënyrë të qatë është shënuar se “*arma nuk mbahet, përveç qëllimeve shenjëtarie*”, nuk ka të dhëna që i njëjti më parë ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale, është penduar për kryerjen e kësaj vepre. Në mungesë të rrethanave veqanarisht rënduese gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale ku, mbi bazën e rrethanave të tilla të pandehurit i shqiptoi dënim me gjobë në lartësi prej **300 € (treqind euro) €**, me bindjen se në rastin konkret edhe përmesë këtij dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit me gjobë dhe qëllimi i përgjithëshëm i dënimeve, në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale duke konsideruar se një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejt në raport me peshën e vepres penale, rrethanave të kryerjesë së vepres penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.


*Konformë nen. 374 par .3 të KPRK-së, arma – revolja e llojit Smith & Wesson e modelit M&P9 me numër serik DXM5502 me dy karikator dhe 22 fishek të kalibrit 9 mm, si dhe leja për armë shenjëtarie me numër AB1212013281486, konfiskohen në mënyrë të përhershme.*

Konform nenit 450 par.2 nënpar 2.6 të KPPK-së, është obliguar i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 (tridhjet) euro, e cila është caktuar duke pasur parasysh gjendjen ekonomike të pandehurit dhe komplikushmerinë e kësaj çështje penale.

Nga arsyet e sipërcekura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI PËR KRIME TË  
RËNDA PKR.179/16, dt. 12.01.2017**

**Sek. juridike**  
Adelina Sallahu



**KËSHILLA JURIDIKE**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, për mes kësaj Gjykate.